



## NJOFTIM PËR SHTYP

Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale i Republikës së Maqedonisë së Veriut (KRRE) solli vendimin, me të cilin bëhet **ulja** e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës mesatarisht **0,10 %** në raport me vendimin e datës 8.6.2026.

Çmimet referente të derivateve të naftës në tregun botëror, në krahasim me përlogaritjen e mëparshme shënojnë ulje mesatarisht: te benzina për 2,178 %, te nafta për 4,441 %, te vaji ekstra i lehtë për 5,099 % dhe te mazuti ulja është 3,635 % .

Kursi i denarit në raport me dollarin në periudhën e kaluar, sipas të cilit janë formuar çmimet në përlogaritjen e mëparshme, është **më i lartë për 0,5395%**.

Në këtë përlogaritje, KRRE-ja i përlogariti shumat referente të akcizave për EUROSUPER BS-95, EUROSUPER BS-98 dhe EURODIZEL (D-E V), duke e pasur parasysh skadimin e Vendimit për Ndryshimin e Vendimit për Përcaktimit të Llojit të Burimeve të Energjisë, Periudhës Kohore dhe Mënyrës së Përlogaritjes së Akcizës.

**Nga data 16.6.2026, ora 00:01 çmimet maksimale të derivateve të naftës do të jenë:**

<b>Benzinë motori</b>	<b>EUROSUPER BS - 95</b>	<b>87,50 (denarë/litër)</b>
<b>Benzinë motori</b>	<b>EUROSUPER BS - 98</b>	<b>90,00 (denarë/litër)</b>
<b>Naftë motori</b>	<b>EURODIZEL BS (D-E V)</b>	<b>87,50 (denarë/litër)</b>
<b>Vaj për Djegie</b>	<b>Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)</b>	<b>86,50 (denarë/litër)</b>
<b>Mazut M-1 SU</b>		<b>46,223 (denarë/kilogram)</b>

Çmimi i shitjes me pakicë i benzinës **EUROSUPER BS-95** rritet për **1,50 den/l**.

Çmimi i shitjes me pakicë i benzinës **EUROSUPER BS-98** rritet për **2,00 den/l**.

Çmimi i shitjes me pakicë i **EURODIZELIT (D-E V)** rritet për **0,50 den/litër**.

Çmimi i shitjes me pakicë i **Vajit Ekstra të Lehtë për Amvisëri (EL-1)** ulet për **2,50 denar/l**.

Çmimi i shitjes me pakicë i **Mazutit M-1 SU** ulet për **1,074 den/kg** dhe do të jetë **46,223 den/kg**.

Theksojmë se këto janë çmimet maksimale të derivateve të naftës nga ora 00:01 e datës 16.6.2026. Tregtarët me shumicë dhe pakicë të derivateve të naftës dhe të karburanteve për transport mund të vendosin çmime të veçanta për derivatet e naftës dhe të karburanteve për transport edhe më të ulëta se çmimet më lartë të përcaktuara.

15.6.2026

